



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 22 prill 2026

Kodi i ZRRE-së: V_3209_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, paragrafi 8, paragrafi 9 dhe paragrafi 10, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 16, Paragrafi 1.11 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë Ligji Nr. 05/L-081); Dispozitat e Nenit 12 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit; dhe Kërkesën e KOSTT SH.A, me nr. prot. 1681 të datës 09.07.2025 për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2035,

në seancën e mbajtur me datë **22.04.2026** nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - Plani Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2035 për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A
- II. OBLIGOHET** – KOSTT SH.A, që të zbatoj projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Transmetimit.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) me datë 09.07.2025, përmes shkresës me nr. prot. 1681, ka pranuar kërkesën për aprovim të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2035.
- ZRRE pas vlerësimit të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit, të njëjtin e ka hapur për diskutim publik për të pranuar komete, sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarat po ashtu edhe nga palët e interesit.
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta mes ZRRE, KOSTT dhe KEDS rreth harmonizimit të planeve, ZRRE ka vlerësuar se janë përfshirë të gjitha komentet dhe arsyetimet e nevojshme për shqyrtim dhe aprovim.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2035, ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe



ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: **Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2035.**

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtar

Adrian Preniqi, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të ZRRE-së.